



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Tiranë, më __.08.2024

Lënda: Mbi dërgimin e raportit të monitorimit të shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për 8-mujorin e vitit 2024.

Ministria e Mbrojtjes administron dhe menaxhon fondet publike, sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”;
- 2) Programi “Forcat e Luftimit”;
- 3) Programi “Mbështetja e Luftimit”;
- 4) Programi “Arsimimi Ushtarak”;
- 5) Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”;
- 6) Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”;
- 7) Programi “Emergjencat Civile”.

• **KARAKTERISTIKAT KRYESORE TË PERFORMANCËS**

Për 8-mujorin e vitit 2024 evidenca e realizimit të shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin me ndryshime të kësaj periudhe, (përfshirë shpenzimet me financim të brendshëm, investimet dhe me financim të huaj) paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 1

në 000/lekë

Ministria e Mbrojtjes											
Programet		Shpenzime Faktike	Str.shp në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2024	Str.shp në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024	Str.shp në %	Ndryshim i i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/ Progresive	Str.shp në %	Diferenca
Nr.	Emri i Programit	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)
1	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,596,104	5	1,563,300	3	1,570,097	53	6,797	1,177,768	6	392,329
2	Forcat e Luftimit	13,306,430	44	24,939,590	52	26,464,441	16	1,524,851	7,925,146	42	18,539,295
3	Mbështetja e Luftimit	6,178,973	20	8,020,436	17	8,061,911	4	41,475	3,645,742	20	4,416,169
4	Mbështetja për Shëndetësinë	1,464,494	5	1,906,000	4	1,961,138	3	55,138	858,253	5	1,102,885
5	Arsimi Ushtarak	982,516	3	1,327,000	3	1,328,478	10	1,478	528,584	3	799,894
6	Mbështetje për Ushtarakët	5,280,308	17	5,200,000	11	5,200,000	11	0	4,000,000	21	1,200,000
7	Emergjencat Civile	1,789,587	6	5,382,050	11	5,400,211	100	18,161	572,892	3	4,827,319
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë		30,598,413	100	48,338,376	100	49,986,276	197	1,647,900	18,708,385	100	31,277,891

Në mosrealizimin në nivelin e planifikimit të shpenzimeve operative ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga për mosplotësim të strukturave të miratuara në të gjithë programet, mosrealizimi në shpenzimet për mallra dhe shërbime si rrjedhojë e procedurave të prokurimit.

Ndërsa shpenzimet buxhetore për “Investime” vetëm me financim të brendshëm, duke përjashtuar *investimet dhe me financim të huaj*, niveli i realizimit është 30% dhe situata për çdo program për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 paraqitet e tillë:

Tabela nr. 2

në 000/lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti me ndryshime 8-mujor (limiti)	Struktura në %	Fakti 8-mujor i vitit 2024		
				në 000/ lekë	Realizimi në %	Struktura në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,570,097	3	1,177,768	75	6
2.	Forcat e Luftimit	26,464,441	52	7,925,146	30	42
3.	Mbështetja e Luftimit	8,061,911	17	3,645,742	45	20
4.	Arsimimi Ushtarak	1,961,138	4	858,253	44	5
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,328,478	3	528,584	40	3
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	11	4,000,000	77	21
7.	Emergjencat Civile	5,400,211	11	572,892	11	3
Totali		49,986,276	100	18,708,385	37	100

Për të gjitha programet në nivel ministrie **realizimi i shpenzimeve korrente** paraqitet me 61%, duke variuar nga më i ulëti programi “Emergjencat Civile” me 11%, programi “Forca e Luftimit” me 30 %, programi “Mbështetje për Shëndetësinë” me 40 %, programi “Arsimi Ushtarak” me 44%, programi “Mbështetja e Luftimit” me 45%, deri te dy programet me realizim më të lartë programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi” me 75% dhe “Mbështetje Sociale për Ushtarakët” me 77%.

Nga një vështrim i përgjithshëm, duke gjykuar vetëm mbi realizimin në vlerë të shpenzimeve të planifikuara për 4-mujorin e dytë të vitit 2024, **niveli i realizimit është 65.7 % e krahasuar me buxhetin e planifikuar për vitin 2024,**

Ndërsa sipas zërave të shpenzimeve buxhetore vetëm me financim të brendshëm, niveli i realizimit është 16 % kundrejt planit të buxhetit të vitit 2024, **ndërsa krahasuar me buxhetin e 4-mujorit të dytë të vitit 2024 realizimi është në masën është 39.8%** dhe situata për çdo program paraqitet e tillë:

Tabela nr. 3

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime kapitale të brendshme
		të 4-mujorit të dytë, viti 2024
		(në %)
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	12,600
2.	Forcat e Luftimit	3,775,429
3.	Mbështetja e Luftimit	321,570
4.	Arsimimi Ushtarak	24,238
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	3,204
6.	Emergjencat Civile	168,388
TOTALI		4,305,429

Në zërin e shpenzimeve **kapitale të brendshme, ministria paraqitet me realizim prej 16%.**

Duke iu referuar aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit, ndër 7 programet e ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë 4-mujorit të dytë të vitit 2024:

Tabela nr. 4

në 000/lekë

Emërtimi i programit	Struktura e shpenz. sipas buxhetit fillestar 8-mujori i vitit 2024 në %	Struktura e shpenz. sipas buxhetit me ndryshime 8-mujori i vitit 2024 në %
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3	3
Forcat e Luftimit	52	53
Mbështetja e Luftimit	17	16
Mbështetja për Shëndetësinë	4	4
Arsimimi Ushtarak	3	3
Mbështetje për Ushtarakët	11	10
Emergjencat Civile	11	11
Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	100	100

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve në parashikimet sipas **buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, ka ndryshime në disa programeve buxhetore.**

Duke krahasuar strukturën e programeve sipas realizimit faktik gjatë periudhës dhe buxhetit me ndryshime konstatohet se niveli i realizimit në vlerë sipas strukturës së tyre në buxhetin e ministrisë për 4- mujorin e dytë të vitit 2024 paraqitet në tabelë:

Tabela nr. 5

në 000/lekë

Nr.	Emri i programit	Buxheti me ndryshime 8-mujori (limiti)	Struktura në %	Fakti 8-mujor i vitit 2024		
				në 000/ lekë	Realizimi në% (përfshirë investimi me financim të huaj)%	Realizimi në% (pa përfshirë investimi me financim të huaj)%
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,570,097	3	1,177,768	75	6
2.	Forcat e Luftimit	26,464,441	52	7,925,146	30	42
3.	Mbështetja e Luftimit	8,061,911	17	3,645,742	45	20
4.	Arsimimi Ushtarak	1,961,138	4	858,253	44	5
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1.328.478	3	528.584	40	3
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	11	4,000,000	77	21
7.	Emergjencat Civile	5,400,211	11	572,892	11	3
	Totali	49,986,276	100	18,708,385	37	100

Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 1, datë 24.01.2024, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; si dhe në zbatim të VKM nr. 929, datë 17.11.2010, “Për krijimin dhe përdorimin

e fondit të veçantë”, të ndryshuar, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes paraqitet me rritje në vlerën në artikullin 606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”, në vlerën **30,900 mijë** lekë, sipas çdo programi ndryshimet paraqiten:

- “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 1,497 mijë lekë.
- “Forca e Luftimit”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar rritje me 9,031 mijë lekë.
- Mbështetja e Luftimit”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar ka rritje me 16,505 mijë lekë.
- “Arsimimi Ushtarak”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar rritje me 1,478 mijë lekë.
- “Mbështetje për Shëndetësinë”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar rritje me 1,838 mijë lekë.
- “Emergjencat Civile”, buxheti i rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar rritje me 551 mijë lekë.

Tabela nr. 6

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Ndryshimi i planit vjetor për periudhën raportuese për fondin e veçantë
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,497
2.	Forcat e Luftimit	9,031
3.	Mbështetja e Luftimit	16,505
4.	Arsimimi Ushtarak	1,478
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,838
6.	Mbështetje për Ushtarakët	0
7.	Emergjencat Civile	551
	Totali i shtesës së Ministrisë	30,900

Ndryshimet në buxhet për 8-mujorin e vitit 2024 janë:

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit për këtë periudhë paraqitet me ulje në vlerën 1,647,900 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar, sipas artikujve buxhetorë në mijë lekë:

- **Shtesë** në artikullin 600+601: Mbi zbatimin e VKM nr. 422, datë 26.06.2024 dhe VKM nr.424., datë 26.06.2024, në shumën 113,000 mijë lekë.
- **Shtesë** në artikullin 606 Transferta familjare”, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave nr.2655/1 prot., datë 12.03.2024, “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024”, në shumën 30,900 mijë lekë.
- **Shtesë** në artikullin 231: Mbi zbatimin e VKM nr.300., datë 17.05.2024, në shumën 1,504,000 mijë lekë.
- **Pakësim** në artikullin 231: Shpenzime kapitale me financim të huaj, në shumën 12,212,050 mijë lekë. Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 97/2023, “Për buxhetin 2024”, evidentohet ndryshim (pakësim) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj”. Këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në programin “Forcat e Luftimit” dhe “Emergjencat Civile”.

PERFORMANCA DHE STATUSI I PRODUKTEVE SIPAS PROGRAMEVE:

Tabela Nr. 7

në 000 /lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzim e korrente (Fakti 8-mujor i vitit 2024)		Shpenzim e kapitale (Fakti 8-mujor i vitit 2024)				Totali				Totali shpenzimeve
		Produkte	Vlera	Total Projekte	Vlera	Projekte të Realizuara	Produkte + projekte	Realizimi (Produkte dhe projekte)	Buxheti me ndryshime 8-M 2024	Dif. Buxheti me #, me Buxhetin fillestar	Fakti 8-mujor i vitit 2024	
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	3	1,165,168	5	12,600	1	8	4	1,563,300	1,570,097	1,177,768	
2.	Forcat e Luftimit	4	4,149,717	31	3,775,429	11	35	15	24,939,590	26,464,441	7,925,146	
3.	Mbështetja e Luftimit	13	3,324,172	51	321,570	13	64	26	8,020,436	8,061,911	3,645,742	
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1	504,345	2	24,238	1	3	2	1,906,000	1,961,138	528,584	
5.	Arsimimi Ushtarak	1	855,049	8	3,204	1	9	2	1,327,000	1,328,478	858,253	
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5	4,000,000	-	-	-	5	5	5,200,000	5,200,000	4,000,000	
7.	Emergjencat Civile	5	404,505	14	168,388	5	19	10	5,382,050	5,400,211	572,892	
	TOTALI	32	14,402,956	111	4,305,429	32	143	64	48,338,376	49,986,276	18,708,385	

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”

Në bazë të informacioneve të paraqitura, drejtuesit e njërive shpenzuese, ku fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 3% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për 4-mujorin e dytë të vitit 2024. Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike.

Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 disa nga objektivat kryesorë janë:

1. Sigurimi i menaxhimit eficient dhe efektiv të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes.
2. Modernizimi i infrastrukturës së Ministrisë së Mbrojtjes.
3. Funksionimi eficient i sigurt, si dhe modernizim i mëtejshëm i infrastrukturës së teknologjisë dhe informacionit.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 3 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 5 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 6,797,015 mijë lekë në shpenzime korrente.

Nga analiza e koston së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt nuk ka ndryshime. Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 janë parashikuar 8 produkte me vlerë 1,570,097 mijë lekë dhe janë realizuar 4 produkte me vlerë 1,177,768 mijë lekë ose 75 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.8

në 000/lekë

	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime FAKTIKE	MBETJE	% e Realizimit	NDRYSHIME
PROGRAMI BUXHETOR “PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM”	600	590,562	477,262	412,462	64,800	86	-113,300
	601	104,418	90,898	63,385	27,513	70	-13,520
	602	399,896	561,896	489,861	72,035	87	162,000
	603	0	0	0	0	0	0
	604	0	0	0	0	0	0
	605	275,424	245,544	165,200	80,344	67	-29,880
	606	33,000	34,497	34,261	236	99	1,497
	231	160,000	160,000	12,600	147,400	8	0
	231/2						0
	TOTALI	1,563,300	1,570,097	1,177,768	392,329	75	6797

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente	83%
Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale	8%

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 1,177,768 mijë lekë ose 75%.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Programi “Forcat e Luftimit” përmban 3 nënprograme: **Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare dhe Komanda e Forcës Ajrore**. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike.

Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 disa nga objektivat kryesore janë:

- Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore.
- Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Detare.
- Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore.

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 53 % të buxhetit me ndryshime, të miratuar për periudhën raportuese, dhe janë shpenzuar për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 4 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 31 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 1,524,851 mijë lekë.

- Shtesë në shpenzime operative në vlerën 20,851 mijë lekë, për rritjen e pagave dhe shtesë për fondin e veçantë.
- Shtesë në shpenzime kapitale në vlerën 1,504,000 mijë lekë, sipas VKM nr.300, datë 17.05.2024, “Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes miratuar për vitin 2024, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për modernizimin e Forcave të Armatosura”.

Për 8-mujorin e vitit 2024 janë parashikuar 35 produkte me vlerë 26,464,441 mijë lekë dhe janë realizuar 15 produkte me vlerë me 7,925,146 mijë lekë ose 30 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin e vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.9

në 000/lekë

	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime faktike	MBETJE	% e Realizimit	NDRYSHIME
PROGRAMI BUXHETOR “FORCA E LUFTIMIT”	600	3,417,000	3,536,320	2,284,569	1,251,751	65	119,320
	601	435,000	514,900	387,346	127,554	75	79,900
	602	2,463,090	2,275,690	1,440,545	835,145	63	-187,400
	603	0	0	0	0		0
	604	0	0	0	0		0
	605	0	0	0	0		0
	606	40,000	49,031	37,257	11,774	76	9,031
	231	18,584,500	20,088,500	3,775,429	16,313,071	19	1,504,000
	231/2			0	0		0
	TOTALI	24,939,590	26,464,441	7,925,146	18,539,295	30	1,524,851

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin e vitit 2024, në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Në shpenzime operative janë realizuar 4 produkte me vlerë 4,149,717 mijë lekë ose 65%.

Në shpenzime kapitale përfshirë dhe investimin me financim të huaj janë realizuar 11 projekte me vlerë 3,775,429,383 mijë lekë ose 19%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 7,925,146mijë lekë ose 30 %.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Programi “Mbështetja e Luftimit” përmban 13 nënprograme: Komanda Mbështetëse, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes Muzeu i FA-së, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Agjencia e Sistemit të Ndërlidhjes dhe Informacionit, Batalioni i Mbështetjes, Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, Qendra e Personel-Rekrutimit, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Qendra e Menaxhimit të Materialeve, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre.

Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 disa nga objektivat kryesore janë:

- Objektivi 1: Sigurimi i logjistikës së nevojshme, si dhe mbështetja në operacione humanitare e misione ndërkombëtare.
- Objektivi 2: Sigurimi i inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet.
- Objektivi 3: Sigurimi dhe mbështetja e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s.

- Objektivi 4: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak dhe civil.

Fondet e miratuara për këtë program përbëjnë rreth 16.1% të buxhetit me ndryshime, të miratuar për periudhën raportuese, dhe janë shpenzuar për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 13 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 51 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën 41,475 mijë lekë.

Shtesë në shpenzime operative në vlerën 41,475 mijë lekë, për rritjen e pagave dhe shtesë për fondin e veçantë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.10

në 000 lekë

	LLOGARIA EKONOMIK E	PLANI FILLESTA R	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime faktike	MBETJE	% e Realizimi t	NDRYSHIM E
PROGRAMI BUXHETOR “MBËSHTETJE A E LUFTIMIT”	600	3,042,000	3,062,418	1,912,654	1,149,765	62	20,418
	601	461,000	502,975	327,757	175,218	65	41,975
	602	2,928,000	2,890,576	895,890	1,994,686	31	-37,424
	603	0	0	0	0		0
	604	0	0	0	0		0
	605	0	0	0	0		0
	606	323,936	340,441	187,871	152,570	55	16,505
	231	1,265,500	1,265,500	321,570	943,930	25	0
	231/2	0	0	0	0		0
	TOTALI	8,020,436	8,061,911	3,645,742	4,416,169	45	41475

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente 49%

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve kapitale 25 %

Gjithsej 45%

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

4. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 4 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për periudhën raportuese. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë” ka parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 objektivat kryesorë janë:

- Objektivi 1: Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës së SUT-së
- Objektivi 2: Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacientëve të afëruara nga specialitetet mjekësore pranë SUT-së

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 2 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 55,138 mijë lekë në shpenzime operative.

Për 8-mujorin e vitit 2024 janë parashikuar 3 produkte me vlerë të rishikuar **1,961,138 mijë lekë** dhe janë realizuar 2 produkte, me vlerë **858,253 mijë lekë** ose 44 %.

Realizimi i objektivave të mësipërm bëhet nëpërmjet planifikimit të 1 produkti në zërat e “Shpenzime Korrente” dhe 2 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”.

Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është rritur në vlerën **55,138 mijë lekë**, shtesë në shpenzime operative në vlerën 55,138 mijë lekë, për rritjen e pagave dhe shtesë për fondin e veçantë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.11

në 000 lekë

	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	SHPENZIME FAKTIKE	MBETJE	% e REALIZIMIT	NDRYSHIME
PROGRAMI BUXHETOR “MBËSHETETJE PËR SHËNDETËSINË”	600	517,348	571,938	365,134	206,804	64	54,590
	601	88,488	96,518	60,177	36,341	62	8,030
	602	798,164	788,844	427,588	361,256	54	-9,320
	603	0	0	0	0	0	0
	604	0	0	0	0	0	0
	605	0	0	0	0	0	0
	606	2,000	3,838	2,150	1,688	56	1,838
	231	500,000	500,000	3,204	496,796	1	0
	231/2	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	1,906,000	1,961,138	858,253	1,102,885	44	55,138

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

Në shpenzime operative është realizuar 1 produkt me vlerë 855,049 mijë lekë ose 59%.

Në shpenzime kapitale janë realizuar 1 projekte, me vlerë 3,204 mijë lekë ose 1 %.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 858,253 mijë lekë ose 44 %.

5. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 3 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për periudhën raportuese. Ky program synon rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 objektivat kryesorë janë:

Arsimimi në të tri ciklet e studimit dhe kualifikimin në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare të personelit ushtarak e civil, për të gjitha nivelet e drejtimit dhe komandimit të FARSH-it dhe institucioneve të tjera të sigurisë kombëtare.

- Kualifikimi dhe përgatitja, menaxhimi, zhvillimi dhe vlerësimi i stërvitjes individuale bazë me rekrutët kandidatë për ushtarë/detarë aktivë dhe stërvitjes individuale të avancuar në bashkëpunim me strukturat e FA-së.
- Përgatitja e personelit ushtarak dhe civil në FA, në përputhje me detyrat që burojnë nga misionet kushtetuese të strukturave të Forcave të Armatosura në kuadër të mbrojtjes kolektive të NATO-s dhe sigurisë kombëtare, si dhe për pjesëmarrjen në operacionet e emergjencave civile.
- Modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve për arsimim, trajnim, stërvitje dhe kualifikim në të gjitha strukturat e AFA-së, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Bashkërendimi i veprimtarinë së AFA-së me MASR-në dhe me institucione të tjera të të gjitha niveleve brenda dhe jashtë vendit, për realizimin cilësor të programeve akademike.

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 1 produkti në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 8 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”. Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 1,478 mijë lekë në shpenzime operative, në art. 606 “Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë.

Tabela nr.12

në 000 lekë

	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	SHPENZIME FAKTIKE	MBETJE	% E REALIZIMIT	NDRYSHIME
PROGRAMI BUXHETOR “ARSIMIMI USHTARAK”	600	554,000	493,000	265,283	227,717	54	-61,000
	601	95,000	98,000	62,979	35,021	64	3,000
	602	91,000	99,000	57,012	41,988	58	8,000
	603	0	0	0	0	0	0
	604	0	0	0	0	0	0
	605	0	0	0	0	0	0
	606	130,000	181,478	119,072	62,406	66	51,478
	231	457,000	457,000	24,238	432,762	5	0
	231/2	0	0	0	0	0	0
	TOTALI	1,327,000	1,328,478	528,584	799,894	40	1,478

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin e vitit 2024 në këtë program buxhetor rezulton, si më poshtë:

- Në shpenzime operative në vlerë 504,345 mijë lekë ose 58%.
- Në shpenzime kapitale 24,238 mijë lekë ose 5%.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 528,584 mijë lekë ose 40% ndaj buxhetit me ndryshime të Ministrisë së Mbrojtjes.

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Arsimimi Ushtarak” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar, produktet me kostot përkatëse që kontribuojnë në realizimin e tyre.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”

Fondet e miratuara për këtë program shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërme, nëpërmjet 5 produkteve. Për këtë program vërejmë se nuk ka ndryshim të planit të produkteve.

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 10% të buxhetit me ndryshime të miratuar për periudhën raportuese. Programi “**Mbështetje Sociale për Ushtarakët**” ka parashikuar objektiva specifike.

Për 4- mujorin e dytë të vitit 2024 objektivat kryesorë janë:

- Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare.
- Trajtim të veçantë të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim.
- Transferta të brendshme për përballimin e pensioneve të parakohshme të ushtarakëve.

Për këtë program vërejmë se nuk ka ndryshim të planit të produkteve në krahasim me buxhetin fillestar.

Për 8-mujorin e vitit 2024 janë parashikuar 5 produkte, me vlerë 5,200,000 mijë lekë dhe janë realizuar 5 produkte, me vlerë 4,000,000 mijë lekë ose 77 %.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 8-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.13

në 000 lekë

PROGRAMI BUXHETOR “MBËSHTETJE SOCIALE PËR USHTARAKËT”	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	NDRYSHIME	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime faktike	MBETJE	% e Realizimit
	604	5,200,000	0	5,200,000	4,000,000	1,200,000	77
	TOTALI	5,200,000	0	5,200,000	4,000,000	1,200,000	77

Realizimi i fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente 77%.

7. Programi “Emergjencat Civile”.

Programi “**Emergjencat Civile**” përmban 2 nënprograme: Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 objektivat kryesorë janë:

Objektivi 1: Zvogëlimi i humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

Objektivi 2: Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore.

Fondet e miratuara për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 për këtë program përbëjnë 11 % të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe shpenzohen për realizimin e objektivave të mësipërm, nëpërmjet 5 produkteve në zërat “Shpenzime Korrente” dhe 14 projekte investimi në zërin “Shpenzime Kapitale”.

Për 8-mujorin e vitit 2024, janë parashikuar 5 produkte dhe 14 projekte me vlerë totale 5,382,050.

Për këtë program vërejmë se ndryshimi i planit të produkteve është shtuar në vlerën 18,161 mijë lekë, shtesë në shpenzime operative në vlerën 18,161 mijë lekë, për rritjen e pagave dhe shtesë për fondin e veçantë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas grup artikujve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 në këtë program buxhetor duke e krahasuar me buxhetin vjetor të miratuar rezulton, si më poshtë:

Tabela nr.14

në 000 lekë

PROGRAMI BUXHETOR “EMERGJENCAT CIVILE”	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime faktike	MBETJE	% e Realizimit	NDRYSHIME
	600	164,000	187,072	118,681	68,390	63	23,072
	601	27,000	30,988	19,737	11,251	64	3,988
	602	441,000	431,551	133,210	298,341	31	-9,449
	603	0	0	0	0	0	0
	604	800,000	800,000	121,505	678,495	15	0
	605	18,000	18,000	11,183	6,817	62	0
	606	0	551	189	362	34	551
	231	3,932,050	3,932,050	168,388	3,763,662	4	0
	231/2					0	0
	TOTALI	5,382,050	5,400,211	572,892	4,827,319	11	18,161

Në shpenzime operative janë realizuar 5 produkte, me vlerë 404,505 mijë lekë ose 28%.
Në shpenzime kapitale është realizuar 1 projekt, me vlerë 168,388 mijë lekë ose 4 %.

Statusi i realizimit të këtyre produkteve është në vlerën 572,892 mijë lekë ose 11%.

KRAHASIMI I TË DHËNAVE FAKTIKE NDËRMJET MINISTRISË DHE THESARIT

Nga të dhënat faktike (financim i brendshëm + huaj) të shtatë programeve të Ministrisë së Mbrojtjes me situacionet raportuese të thesarit për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 paraqiten:

Tabela nr.15

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali shpenzimeve		
		Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,165,168	1,165,168	0	12600	12600	0	1,177,768	1,177,768	0
2.	Forcat e Luftimit	4,149,717	4,149,717	0	3,775,429	3775429.383	0	7,925,146	7,925,146	0
3.	Mbështetja e Luftimit	3,324,172	3,324,172	0	321,570	321569.7992	0	3,645,742	3,645,742	0
4.	Arsimimi Ushtarak	504,345	504,345	0	24,238	24238.393	0	528,584	528,584	0
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	855,049	855,049	0	3,204	3204	0	858,253	858,253	0
6.	Mbështetje për Ushtarakët	4,000,000	4,000,000	0		0	0	4,000,000	4,000,000	0
7.	Emergjencat Civile	404,505	404,505	0	168,388	168387.683	0	572,892	572,892	0
	TOTALI	14,402,956	14,402,956	0	4,305,429	4,305,429	0	18,708,385	18,708,385	0

Ashtu siç vërtetohet nga tabela e mësipërme, të dhënat e paraqitura nga shtatë programet e Ministrisë së Mbrojtjes për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për 4-mujorin e dytë të vitit 2024 përputhen plotësisht me të dhënat e thesarit për këtë periudhë raportuese.

INFORMACION MBI VOLUMIN DHE MADHËSINË E NDRYSHIMIT TË BUXHETIT

Për shtatë programet e Ministrisë së Mbrojtjes situata në lidhje me ndryshimet në planifikimin e buxhetit gjatë vitit 2024, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin me ndryshime gjatë periudhës raportuese të këtij viti, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.16

në 000 lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Buxheti fillestar viti 2024 (plani)	Buxheti me ndryshime 8-mujori, viti 2024	(Buxh me ndryshime) - (Buxh.fillestar)
1.	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,563,300	1,570,097	6,797
2.	Forcat e Luftimit	24,939,590	26,464,441	1,524,851
3.	Mbështetja e Luftimit	8,020,436	8,061,911	41,475
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1,906,000	1,961,138	55,138
5.	Arsimimi Ushtarak	1,327,000	1,328,478	1,478
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,200,000	-
7.	Emergjencat Civile	5,382,050	5,400,211	18,161
	TOTALI	48,338,376	49,986,276	1,647,900

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit 8-mujor paraqitet me rritje në vlerën **1,647,900 mijë lekë** më shumë se buxheti fillestar. Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program buxhetor.

NDRYSHIMET SIPAS ARTIKUJVE EKONOMIKË

Tabela nr.17

në 000/lekë

Programet	600	601	602	603	604	605	606	231B	231H	Totali
Planifikim Menaxhimi	(113,300)	(13,520)	162,000	-	-	(29,880)	1,497	-	-	6,797
Forca e Luftimit	119,320	79,900	(187,400)	-	-	-	9,031	1,504,000	-	1,524,851
Mbështetja e Luftimit	20,418	41,975	(37,424)	-	-	-	16,505	-	-	41,475
Mbështetje për Shëndetësinë	54,590	8,030	(9,320)	-	-	-	1,838	-	-	55,138
Arsimimi Ushtarak	(61,000)	3,000	8,000	-	-	-	51,478	-	-	1,478
Mbështetje për Ushtarakët	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Emergjencat Civile	23,072	3,988	(9,449)	-	-	-	551	-	-	18,161
	43,100	123,373	(73,593)	-	-	(29,880)	80,900	1,504,000	-	1,647,900

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit 8-mujor paraqitet me rritje në vlerën 1,647,900 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar. Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 kemi shtesë fondi në shumën 43,100 mijë lekë;

Në artikullin 601 kemi shtesë fondi në shumën 123,373 mijë lekë;

Në artikullin 602 kemi pakësim fondi në shumën -73,593 mijë lekë;

Në artikullin 605 kemi pakësim fondi në shumën -29,880 mijë lekë;

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 80,900 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi shtesë fondi në shumën 1,504,000 mijë lekë krahasuar me buxhetin fillestar.

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit për 4- mujorin e dytë të vitit 2024 janë:

- Shkresa e Ministrisë së Financave “Dërgohet miratimi i fondit të veçantë për vitin 2024”, dërguar me shkresën e MM nr.2655/1prot., datë 12.03.2024.
- Rishpërndarje fondesh sipas shkresës së MM nr.1883/2, datë 9.4.2024.
- Shkresa e Ministrisë së Financave “Transferim fondi për vitin 2024”, dërguar me shkresën e MM nr. 4981/1prot., datë 25.04.2024.
- Shkresa e Ministrisë së Financave “Miratim Limiti”, dërguar me shkresën e MM nr. 4980/1prot., datë 25.04.2024.
- VKM nr.300, datë 17.05.2024, në shumën 1, 504,000 mijë lekë ”Për një shtesë fondi në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar për vitin 2024, në artikullin 231 “Investime” nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për modernizimin e Forcave të Armatosura.
- VKM nr. 422, datë 26.06.2024 dhe VKM nr. 424, datë 26.06.2024, në shumën 113,000 mijë lekë, Shtesë në artikullin 600+601:
- Artikullin 606 “Transferta familjare”, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave nr.2655/1, datë 12.03.2024, “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024”.

INVESTIMET E HUAJA

Krahasuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 97/2023, “Për buxhetin 2024”, evidentohet ndryshimi (pakësimi) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj” **në shumën 12,212,050 mijë lekë**. Këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në programin “Forcat e Luftimit” dhe “Emergjencat Civile”.

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË KRIJUARA RISHTAZI

Detyrimet e prapambetura e të krijuar rishtazi për periudhën, të raportuara nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes, janë në vlerën rreth 628,199 mijë lekë. Sipas natyrës këto detyrime kategorizohen, si më poshtë:

- Detyrime për “Shpenzime personeli”, në vlerën 151 milionë lekë, të cilat janë detyrime të akumuluar për pagesë kontributesh.
- Detyrime në zërin “Mallra dhe shërbime”, në vlerën 67 milionë lekë, detyrime për kontrata dhe fatura të paguara.
- Detyrime në zërin “Vendime gjyqësore”, në vlerën 56 milionë lekë, pjesa më e madhe e detyrimit janë shpenzime në artikullin 604, për përballimin e fatkeqësive natyrore, detyrime që janë krijuar nga ish-DPEC.

Theksojmë se këto detyrime i përkasin detyrimeve të prapambetura të trashëguara ndër vite.

Për 4-mujorin e dytë të vitit 2024, janë bërë kërkesat përkatëse në fazën I dhe II, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, por referuar analizave të realizimit të pritshëm të buxhetit, do të shihet mundësia e rialokimit të fondeve midis artikujve, me qëllim likuidimin total të detyrimeve të prapambetura.

Si konkluzion, në total realizimi i buxhetit (FB+FH) të 4-mujorit të dytë të vitit 2024 për Ministrinë e Mbrojtjes, është në masën 37.5 % të specifikuar sipas kategorive kryesore të shpenzimeve, si më poshtë:

a) Shpenzimet korrente janë realizuar në masën 61 %, prej të cilave:

Siç shihet nga anekset përkatëse, mosrealizime të theksuara ka në shpenzimet për mallra e shërbime (art. 602), të cilat i përkasin programeve:

“Emergjencat Civile” dhe programi buxhetor “Mbështetja e Luftimit” si mosrealizim të procedurave të prokurimit dhe mosrealizim të pagesave.

b) Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm

Për sa i përket shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me plan vjetor në shumën 14,151 milionë lekë apo 53.7%, kundrejt totalit të buxhetit për investimet kapitale dhe plan 8-mujor në shumën 9,1434 milionë lekë kanë një realizim prej 4,305 milionë lekë ose në masën 30.3%, kundrejt planit vjetor të buxhetit për investimet me financim të brendshëm.

c) Shpenzimet kapitale me financim të huaj janë realizuar në masën 0 %.

Investimet me financimin e huaj, me plan vjetor në shumën 12,212 milionë lekë apo 46.3 % kundrejt totalit të buxhetit për investimet kapitale dhe plan 12-mujor prej 300 milionë lekë, paraqiten me një realizim në shumën 0 milionë lekë ose në masën 0 % ndaj planit vjetor.

Si konkluzion, në total realizimi i buxhetit (FB+FH) të 4-mujorit të dytë të vitit 2024 për Ministrinë e Mbrojtjes, është realizuar në masën 16.3 %.

Në vlerësimin përfundimtar konstatojmë se realizimi i buxhetit në fund të kësaj periudhe nuk është në nivelin të pritshëm, sidomos në zërin “Investime të brendshme” dhe të shpenzimeve për “Mallra e shërbime”, pasi mosrealizimi i fondit ndikohet nga moskryerja e procedurave të prokurimit në kohë, mosplotësimi i numrit të miratuar të punonjësve, si dhe kursimet e fondeve nga procedurat e prokurimit.

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore.

Problematikat e konstatuara gjatë këtij 8-mujori do të jenë objekt i vëmendjes dhe trajtimit, me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vijim.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.